



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura VI**

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,  
Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen  
e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 32

Prishtinë, më 26.6.2018, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Albulena Haxhiu, Hajdar Beqa, Bahrim Shabani, Sami Kurteshi, Arben Gashi, Korab Sejdiu, Bilall Sherifi, Nezir Çoçaj, Shkumbin Demaliaj dhe Frashër Krasniqi.

**Mungoi:** Igor Simiq.

**Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë:** Ediar Krasniqi, KDI; Edib Haziri, Ekonomia Online; Dibran Istrefi, Klan Kosova; Bardha Maxhuni, GLPS; Arta Dehari dhe Berita Abazi dhe Blerta Bejtullahu, EUSR/EV Office.

**Mbledhjen e kryesoi:** Albulena Haxhiu, kryetare e Komisionit.

**Nga stafi mbështetës:** Mirlinda Kolgeci dhe Fatbardha Boletini.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Procedimi i Raportit me amendamente i Projektligjit nr.06/L-010 për Noteri;
3. Procedimi i Raportit me amendamente për Projekt-Kodin e Drejtësisë për të Mitur nr.06/L-006;
4. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 06/L-066 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-064 për Patentë Shofer;

5. Shqyrtimi i dekretit të Presidentit i datës 11.4.2018 ;
6. Shqyrtimi i kërkesës për iniciimin e procedurave për ndryshim plotësimin e Ligjit për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore.
7. Të ndryshme.

### **1. Miratimi i rendit të ditës**

Nezir Çoçaj propozoi që në rend dite të futet si pikë e rendit të ditës, Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, me arsyetimin që është thirrur seancë e jashtëzakonshme për këtë projektligj dhe që duhet trajtuar paraprakisht në Komision.

*Por, pas një diskutimi të gjerë nga anëtarët e Komisionit, kryetarja konstatoi se propozimi i z. Çoçaj nuk u miratua, 5 vota për dhe 5 kundër, ky projektligj nuk mund të përfshihet në rend dite.*

*Rendi i ditës u miratua me ndryshime, duke u shtuar edhe këto pika pas pikës 4 të rendit të ditës; Raporti me amendamente i Projektligjit nr. 06/L-070 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr.04/L-179 për Transportin Rrugor; Raporti me amendamente i Projektligjit nr. 06/L-069 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor; Raporti me amendamente i Projektligjit nr. 06/L-067 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës; Raporti me amendamente i Projektligjit nr. 06/L-068 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr.2003/11 për Rrugë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/L-120; Raporti me amendamente i Projektligjit nr. 06/L071 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-183 për Transportin Tokësor të Mallrave të Rrezikshme.*

### **2. Procedimi i Raportit me amendamente i Projektligjit nr. 06/L-010 për Noteri**

**Kryetarja** paraqiti Raportin me amendamente të Projektligjit nr. 06/L-010 për Noteri. Ajo tha se edhe Raportet e Komisioneve kryesore nuk kanë vërejtje në lidhje me këtë Projektligj dhe kërkoi nga anëtarët të deklarohen nëse kanë vërejtje.

*Meqë nuk pati vërejtje, kryetarja, konstatoi se komisioni njëzëri e procedoi për Kuvend Raportin me amendamente për Projektligjin nr. 06/l-010 për Noteri .*

### **3. Procedimi i Raportit me amendamente i Projekt-Kodit të Drejtësisë për të Mitur nr. 06/L-006**

**Kryetarja**, paraqiti Raportin me amendamente të Projekt-Kodit të Drejtësisë për të Mitur nr. 06/L-006 dhe tha se edhe Raportet e Komisioneve kryesore nuk kanë vërejtje në lidhje me Projekt-Kodin e Drejtësisë për të Mitur dhe kërkoi nga anëtarët të Deklarohen nëse kanë vërejtje.

Meqë nuk pati vërejtje, kryetarja konstatoi se komisioni njëzëri e procedoi Raportin me amendamente për Projekt- Kodin e Drejtësisë për të Mitur nr. 06/L-006.

**4. Shqyrtimi i Raportit me amendamente për Projektligjin-06/L-066 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr.05/L-064 për Patentë Shofer.**

**Kryetarja** paraqiti para komisionit raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL për Projektligjin nr. 06/L-066, për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-064 për Patentë Shofer dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit të deklarohen nëse kanë vërejtje.

*Meqë nuk pati vërejtje, kryetarja konstatoi se komisioni, njëzëri, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:*

**REKOMANDIM**

1. Projektligji nr. 06/L-042 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-064 për Patentë, është në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin e zbatueshëm;
2. Projektligji mund t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

**5. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 06/L-070 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-179 për Transportin Rrugor.**

**Kryetarja** paraqiti para komisionit raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL për Projektligjin nr. 06/L-070, për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-179 për Transportin Rrugor dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit të deklarohen nëse kanë vërejtje.

*Meqë nuk pati vërejtje, kryetarja konstatoi se komisioni, njëzëri, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:*

**REKOMANDIM**

1. Projektligji nr. 06/L-070 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-179 për Transportin Rrugor, është në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin e zbatueshëm;
2. Projektligji mund t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

**6. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 06/L-069 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/ L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor.**

**Kryetarja** paraqiti para komisionit raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL për Projektligjin nr. 06/L-069, për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit të deklarohen nëse kanë vërejtje.

*Meqë nuk pati vërejtje, kryetarja konstatoi se komisioni, njëzëri, vendosi që Komisionit FunkSIONAL t'ia paraqesë këtë:*

### **REKOMANDIM**

1. Projektligji nr. 06/L-069 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor, është në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji mund t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim

### **7. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL për Projektligjin nr. 06/L-067, për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit nr.04/L-063 për hekurudhat e Kosovës.**

**Kryetarja** paraqiti para komisionit raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL për Projektligjin nr. 06/L-067 për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit nr. 04/L-063 për hekurudhat e Kosovës dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit të deklarohen nëse kanë vërejtje.

Meqë nuk pati vërejtje, kryetarja konstatoi se komisioni, njëzëri, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

### **REKOMANDIM**

1. Projektligji nr. 06/L-067 për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit nr. 04/L-063 për hekurudhat e Kosovës, është në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin e zbatueshëm;
2. Projektligji mund t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

### **8. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL për Projektligjin nr.06/L-068 për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit nr. 2003/11 për rrugë, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 03/L-120**

**Kryetarja** paraqiti para komisionit raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL për Projektligjin nr. 06/L-068 për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit nr. 2003/11 për rrugë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/L-120 dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit të deklarohen nëse kanë vërejtje.

Meqë nuk pati vërejtje, kryetarja konstatoi se komisioni, njëzëri, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

### **REKOMANDIM**

1. Projektligji nr. 06/L-068 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 2003/11 për rrugë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/L-120, është në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin e zbatueshëm;
2. Projektligji mund t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

### **9. Shqyrtimi i Raportit me amendamente për projektligjin nr. 06/L-071 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-183 për transportin tokësor të mallrave të rrezikshme**

**Kryetarja** paraqiti para komisionit raportin me amendamente të Komisionit Funkcional për Projektligjin nr. 06/L-071, për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-183 për transportin tokësor të mallrave të rrezikshme dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit të deklarohen nëse kanë vërejtje.

Meqë nuk pati vërejtje, kryetarja konstatoi se komisioni njëzëri vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

### **REKOMANDIM**

3. Projektligji nr. 06/L-071 për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit nr. 04/L-183 për transportin tokësor të mallrave të rrezikshme, është në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin e zbatueshëm;
4. Projektligji mund t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

### **10. Shqyrtimi i dekretit të Presidentit i datës 11.4.2018**

**Kryetarja**, paraqiti për shqyrtim dekretin e Presidentit të datës 11.4.2018, të cilin e ka dërguar znj. Arbenita Mehmeti, për faljen e 14 personave në burgun e Dubravës, ku ka theksuar se midis tyre është edhe vrasësi i babait të saj, që i është falur një pjesë e dënimit. Po ashtu, ka theksuar se kriteret ndaluese për faljen e dënimit sipas ligjit janë kur kemi të bëjmë me vrasje të rëndë dhe mizore, vrasje me paramendim, të cilat janë rrethana rënduese ku nuk mund të jepet falja. Ndërkaq z. Haxhiu tha se në vazhdimësi ka probleme me faljet sa që kanë krijuar goxha mosbesimin në raport me faljet që janë dhënë. Pra, kërkesa është që ne ta trajtojmë këtë shkresë, por nuk e di se cilat janë kompetencat në kuadër të Komisionit për Legjislacion në raport me një dekret të Presidentit dhe propozoi që ndoshta më mirë do ishte që të organizojmë mbikëqyrjen e Ligjit për Faljen.

**Shkumbin Demaliaj**, tha se sikur mos të kishte ndodhur gjykimi, apo dënimi në këtë rast ndoshta nuk do kishim ardhur për të folur për një dekret. Është kompetencë e Presidentit në bazë të ligjit dhe nuk kemi të drejtë të ndërhyjmë në kompetencat e tij. Po ashtu, tha se faljet që janë bërë dhe që nuk është një numër i madh, por kryesisht faljet janë bërë për ata persona që kanë vuajtur një pjesë të dënimit, duke pohuar se faljet janë bërë në bazë të ligjit, ndaj mos ti japim

karakter të konfliktit se kemi të bëjmë me anën emocionale të njerëzve që kanë pasur fatkeqësi në jetë.

**Frashër Krasniqi**, tha se sa i përket faljeve nuk është kundër faljeve dhe amnistisë për veprat penale të caktuara, madje Kosova në këtë aspekt më pak ka pasur falje dhe amnisti në rajon. Por praktikë në Kosovë është se po bëhen falje individuale me emra konkretë. Do ishte shumë në rregull sikur të falesh apo të amnistosh një vepër penale e caktuar ku mund të hiqej p.sh. 30% e dënimit, e cila është praktikë e shumë vendeve në data të caktuara. Ndërsa kjo që po bën Presidenti i cili po fal persona me emra konkretë, lë hapësirë për dyshim që këtu ka keqpërdorim të pozitës. Mund të kuptoj që institucionet e Kosovës tregohen pak më bujare për një kategori personash që kanë kryer krime, mbase nuk duhet ti rëndojmë më shumë, por kur filloi me falje me emra konkretë, atëherë këtu është mundësia më e madhe për manipulim, madje edhe për të bërë shitblerje të faljeve. Kjo praktikë diskutohet shumë nëpër burgje dhe në sistem të drejtësisë se si njerëzit blejnë “falje”, “lirim me kusht”, madje edhe prej vetë Presidentit, duke pohuar se nuk kam fakte por praktika e tillë lë hapësirë shumë të madhe për keqpërdorime. Në këtë kuptim, kjo ankesë mendoj se vjen nga ky problem dhe nuk do të kishte ankesë, nëse falja do ishte bërë e përgjithshme.

**Kryetarja**, tha se ashtu siç e potencoi z. Krasniqi, askush nuk është kundër faljes sepse ekziston edhe në shtetet demokratike të parapara edhe me konventa ndërkombëtare, por mënyra se si janë falur persona të caktuar dhe në qoftë se flasim me znj. në fjalë, e cila ka shkruar letër e dallon që aty fshihen manipulime, por po ashtu edhe lidhja e personave në fjalë me shumë biznese jep sinjale që këtu fshihet diçka. Ndërkaq në dekretin e Presidentit, thuhet që është dënuar me një vepër, ndërsa në anën tjetër, sipas vendimit të gjykatës është për dy vepra, ndaj janë disa elemente që e bën dyshues këtë dekret të faljes. Roli i Komisionit duhet të jetë efikas në këtë drejtim, përmes mbikëqyrjes për faljen.

**Shkumbin Demaliaj**, tha se secili nga ne, edhe qytetarët mund ti drejtohet institucioneve me një shpresë për qasje në dokumente zyrtare. Me këtë rast mund ti drejtohem Zyrës së Presidentit zyrtarisht për ti kërkuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, që ka sjellë deri tek dekreti për falje dhe për të verifikuar se a ka pas shkelje apo jo.

**Frashër Krasniqi**, tha se ka një arsye që secilin vendim të Presidentit ne e shohim me skepticizëm, madje edhe me dyshime për afëra duke thënë se 10 vitet e fundit, shumica e aferave dhe aspektit kriminal është bart prej këtij Presidenti dhe e kemi parë se si i punësojnë gjykatësit, policët dhe çfarë sistemi të drejtësisë kemi. Me dokumente ai e bën një arsyetim, mirëpo, ka hapësirë për dyshim, se përse pikërisht është falur ky person dhe pse nuk janë falur plot të tjerë që ndoshta mund ta meritonin shumë më shumë.

**Bilall Sherifi**, tha se me këto tema janë shumë të rënda dhe nuk mund ta shfrytëzojmë këtë situatë për të bërë luftën politike. Falja është ekskluziviteti i Presidentit, por nuk është në diskrecion të tij. Më tej z. Sherifi sqaroi edhe procedurën, por edhe formimin e komisionit, të cilët shqyrtojnë kërkesat për falje. Presidenti në fund nënshkruan dekretin mbi bazën e arsyeve dhe argumenteve, të cilat ia ka dhënë komisioni profesional. Po ashtu, tha ne mund të debatohet, por nuk kemi të drejtë të japim mendim të përbashkët për këtë çështje. Në kohën kur z. Krasniqi ka qenë u.d. i Presidentit, prokuroria ka filluar hetimet dhe i ka mbyll se nuk pati asnjë provë për

të cilat dyshohet se mund të ketë pasur manipulime në proces. Pra, në aspektin profesional prokuroria e ka mbyll hetimin, pas një kohe të caktuar dhe ka thënë se nuk pati asnjë provë në drejtim të thashethemeve, ashtu siç është pretenduar. Prandaj, mendoj që të krijojmë instrumente brenda ligjit sepse nuk kemi mandat ligjor në lidhje me këtë çështje dhe njëkohësisht ne nuk e posedojmë dosjen e kësaj lënde.

**Hajdar Beqa**, tha se në fushëveprimtarinë Komisionit, nuk kemi të drejtë të shqyrtojmë dekretet e Presidentit dhe në këtë rast dekretin për falje të Presidentit. Ne mund të japim qëndrime politike, por ju mund të dilni dhe të jepni konferenca për shtyp nëse mendoni ta politizoni një rast të tillë, por jo ne tani të analizojmë figurën e Presidentit. Pra, nuk kemi të drejtë ta shqyrtojmë dekretin e Presidentit si Komision. Qytetarët mund të na dërgojnë shumë kërkesa apo shkresa, por do të ishte mirë paraprakisht ne të bisedojmë si Komision për të futur një çështje të tillë në rend dite. Ndiej dhimbje për secilën familje që ka një fatkeqësi të tillë, por dyshimet e tilla, nuk besoj që mund të na shërbejnë për mirë. Andaj, nuk është mirë që në këtë vend, një fatkeqësi që i ndodh dikujt për të përfituar politikisht se nuk përfitohet.

**Frashër Krasniqi**, tha se përtej përmbajtjes ta diskutojmë çështjen e faljeve dhe këtu flitet për keqpërdorime të institucionit të faljes nga ana e Presidentit dhe kur dikush flet për keqpërdorime, mua nuk më mbushet mendja as nga vendimet e prokurorisë. Krasniqi tha se prokuroria, kur ka implikime politike merr vendime të favorshme për partinë që është në pushtet.

**Hajdar Beqa**, tha se nëse mendon që ka keqpërdorime, janë instancat gjyqësore ku mund të bëhet ankesë sepse këtij shteti duhet t'i besojmë dhe në nëse ligji është i keq, të bëjmë përpjekje për ta ndryshuar ligjin, por edhe nëse Kushtetuta është e keqe, po ashtu të bëjmë përpjekje për ta ndryshuar Kushtetutën. Me këtë ligj dhe me këtë Kushtetutë, kompetenca e dekretit i takon Presidentit dhe ne nuk kemi të drejtë për të shqyrtuar atë.

**Arben Gashi**, tha se është një rast shumë i rëndë dhe është problematik për mënyrën se si e trajtojmë. Pra e vërteta është se ka ndodhur një vrasje dhe ka një person të dënuar për këtë vrasje. Po ashtu, institucioni i Presidentit ka të drejtën e faljes dhe falja është nominale dhe individuale përkundër institutit të amnistisë që ka një kategori të veprave penale. Ndërsa në ligjin për Falje kriteret të cilat shqyrtohen gjatë marrjes së vendimit mbi faljen caktohen nga Presidenti në përputhje me Kushtetutën dhe Ligjin në fuqi. Ndërkaq, rrethanat që mund të shqyrtohen gjatë dhënies së faljes, përfshinë por nuk kufizohen vetëm : pesha e krimit, rreziku i recidivizmit, pendimi i sinqertë dhe shfaqja e sjelljeve dhe karakterit të respektueshëm. Meqenëse subjekti që na është drejtuar mendon që është e kërcënuar dhe pretendon që ekziston rreziku i përsëritjes së krimit dhe po ashtu pretendon që krejt familja është në kërcënim dhe sigurisht që është shumë shqetësues. Pra, përmend vetëgjyqësinë elemente tjera traditën, kanunin, hakmarrjen dhe çështja është se çfarë duhet të bëjmë ne sepse edhe nga gjuha që na është drejtuar, duket si një rast pa shpresë. Më tej z. Gashi tha se nuk ka instancë tjetër që e rrëzon dekretin e Presidentit sepse dekreti i Presidentit qëndron mbi vendimin e gjykatës.

**Nezir Çoçaj**, tha se nëse biem pre e qytetarëve për trajtimin e shkresave, nuk mendoj që është mirë sepse nuk është me rregullore e caktuar që mund të merremi me shkresat e individëve. Sa i përket shkëljes ligjore, ka mekanizma institucionalë në Kosovë dhe secili nga ne mund ti drejtohet këtyre mekanizmave sepse ne nuk mund ta luajmë rolin, as të prokurorit, as të

gjykatësit, as të avokatit të popullit dhe as të Gjykatës Kushtetuese. Procedurat u sqaruan edhe nga kolegët se cilat kompetenca i ka Presidenti në Kushtetutës dhe Ligjit, ndërsa sa i përket veçorive dhe historisë së Presidentit, por shumëkush nga ju nuk e pranon dhe ndoshta nuk e pranon edhe Kosovën si shtet të pavarur, nuk e pranon dhe historinë e bujshme dhe të artë të Presidentit, që ka qenë lider i një ushtrie të organizuar mirë dhe që ka kontribuar edhe për Pavarësinë e Kosovës.

Më tej z. Çoçaj, tha se për njerëz që kanë djegur institucione, që kanë djegur qytetarë dhe që kanë sulmuar policinë, pse kanë arsye për dyshim është që nuk çon shumë peshë, madje na bëjnë nder kur nuk i pranojnë këto dhe do ta kisha marrë fyese nëse një kalibër i tillë të vlerëson.

*Pas diskutimeve dhe kundërshtimeve që patën, pozita e lëshoi mbledhjen e Komisionit në këtë pikë të rendit të ditës, ndërsa pikat tjera të rendit të ditës në radhë nuk u shqyrtuan në mungesë të kuorumit.*

Mbledhja përfundoi në orën 13:35.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

---

**Albulena Haxhiu**